



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Raporti Vjetor i Punës
Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi
Viti 2024

Gjilan, 2024

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	3
2. Aktivitetet kryesore të realizuara	6
2.1 Akreditimi dhe Ri-akreditimi	Error! Bookmark not defined.
3. Statistika dhe rezultate kryesore	10
4. Përfundime edhe Rekomandime	12

1. Hyrje

*Përmbledhje e shkurtër e qëllimit të Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi
Qëllimi i raportit: evidentimi i aktiviteteve, arritjeve dhe planeve të ardhshme.*

Cilësia dhe Roli i Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi në UKZ

Universiteti "Kadri Zeka" (UKZ) i kushton rëndësi të veçantë cilësisë në proceset akademike dhe administrative. Qëllimi kryesor është të sigurohet një nivel i lartë i standardeve në arsim dhe hulumtime përmes një sistemi të strukturuar të sigurimit të cilësisë, që është në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sistemi i sigurimit të cilësisë bazohet në tre shtylla kryesore: Dokumentet, Struktura dhe Instrumentet për vlerësim.

Një nga aktivitetet e rregullta është vlerësimi i brendshëm, i cili realizohet përmes instrumenteve të vlerësimit të bazuara në Manualin për Planifikimin dhe Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik. Për secilin vlerësim përgatiten raporte dhe u shpërndahen të gjitha palëve të interesuara. Lidhur me sigurimin e cilësisë, organizohen takime mujore të rregullta me Koordinatorët e Cilësisë, si dhe takime dy mujore me KMCV-ne.

Sistemi i sigurimit të cilësisë

Sistemi i sigurimit të Cilësisë është i bazuar në tri shtylla kryesore; Dokumente, Struktura dhe Instrumentet për vlerësim. Në kuadër të mbikqyrjes së sigurimit të cilësisë universiteti ka paraparë një sërë aktivitete të cilat janë paracaktuar në Kalendarin Vjetor të Cilësisë. Lidhur me realizimin e aktiviteteve hartohet rapori vjetor i cili diskutohet në Këshillin Mbikqyrës për Cilësi edhe Vlerësim (KMCV). Një ndër aktivitetet e rregullta është vlerësimi i brendshëm i cili realizohet përmes instrumenteve për vlerësim duke bazuar në Manualin për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së Stafit Akademik. Gjithashtu për çdo vlerësim hartohen raporte të cilat u dorëzohen të gjitha palëve me interes. Lidhur me sigurimin e cilësisë organizohen takime të rregullta mujore me Koordinatorët e Cilësisë si dhe takime dymujore me KMCV-në.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të sistemit të sigurimit të cilësisë i cili është aktualisht në fuqi dhe duke u implementuar. Si sistem i vendosur në vitet e fundit dhe duke parë ambiciozitetin e tyre, natyrisht që kërkohet më shumë punë në drejtim të cilësisë së implementimit të këtyre instrumenteve dhe poashtu nevojitet fuqizim i proceseve që shpiejnë në ndikimin e këtyre proceseve në cilësinë e punës, shërbimeve dhe cilësinë e të diplomuarve.

Dokumentet	Organet	Instrumentet për vlerësim	Procesi i vlerësimit	Raportet
1.Rregullorja për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit në UKZ Ref .nr.01/2280 Dt. 21/12/2020	1.Senati i UKZ	1.Pyetësor për vlerësim të SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semester	1.Vlerësimi i SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semestrin dimëror	1.Raport për vlerësim të mësimdhënësve nga ana e studentëve për semestrin dimëror
2. Planin Strategjik të UKZ-së 2017-2020 e rishikuar në vitin 2020.Kapitulli 6. Pika 5	2.Këshilli Mbikqyrës i Cilësisë dhe Vlerësimit	2.Pyetësori për vetëvlerësim të stafit akademik	2.Vlerësimi i SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semestrin veror	2.Raport për vlerësim të mësimdhënësve nga ana e studentëve për semestrin veror
3. Rregullore për themelimin dhe funksionimin e Këshillit Mbikqyrës të Cilësisë dhe Vlerësimit (KMCV), Nr.01/2124, dt.08.12.2020	3.Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi	3.Pyetësor për vlerësim Dekani-Mësimdhënësin	3.Procesi i Vetëvlerësimit nga Mësimdhënësit	3.Raport individual për secilin mësimdhënës
4. Manuali për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së Stafit Akademik, Nr. Ref. 01/2281 Dt. 21/12/2020	4.Komisioni i Studimeve	4.Pyetësor për vlerësim të Sherbimeve Administrative nga ana e studentëve	4.Vlerësimi Dekani-Mësimdhënësin	4.Raport individual për secilin mësimdhënës
5. Treguesit Kryesorë të	5.Koordinatorët e Cilësisë	5.Pyetësor për vlerësim të programeve	5.Vlerësimi i objektivave të caktuara nga SA	5.Raport individual për

Performancës në UKZ	nëpër njësi akademike	studimore nga Punëdhënësit	ne PZHI në fillim të vitit akademik	secilin mësimdhënës
6. Sistemi Evropian për transfer të kredive në Universitetin “Kadri Zeka”, Gjilan		6.Pyetësor për vlerësim të programeve studimore nga studentët që diplomojnë	6.Vlerësimi i Programeve të UKZ-së nga Alumni	6.Raporti i vlerësimit nga rezultatet e hulumtimit me Alumni
7. Statuti i UKZ-së			7.Vlerësimi i UKZ-së nga Punëdhënësit	7.Raporti i vlerësimit nga rezultatet e hulumtimit me Punëdhënësit
8. Kalendarit Vjetor për Sigurim të Cilësisë në UKZ			8.Vlerësimi i Kalendarit Vjetor për sigurim të cilësisë	8.Raporti për realizimin e kalendarit vjetor të sigurimit të cilësisë

Figura 1. Sistemi i sigurimit të cilësisë

2. Aktivitetet kryesore të realizuara

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi në Universitetin "Kadri Zeka" (UKZ) është përgjegjëse për koordinimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve që lidhen me përmirësimin e standardeve të arsimit, kërkimit dhe administratës. Në kuadër të mbikëqyrjes së sigurimit të cilësisë, universiteti ka parashikuar një sërë aktiviteteve që janë të paracaktuara në Kalendarin Vjetor të Cilësisë. Lidhur me realizimin e këtyre aktiviteteve, përgatitet një raport vjetor i cili diskutohet në Këshillin për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe të Vlerësimit (KMCV).

Takimet për Hartimin e planit të veprimit në nivel Institucional

Janë zhvilluar takime me menaxhmentin e UKZ-se, dekanët si dhe një pjesë e stafit administrativë për hartimin e planit të veprimit në nivel institucional.

Takimet për Hartimin e planeve të veprimit nëpër njësi akademike

Janë zhvilluar takime dekanët e secilës njësi akademike, stafin akademik të njësive si dhe një pjesë e stafit administrativë për hartimin e planit të veprimit për njësi akademike, të njëjtat janë dorëzuar të Koordinatorët e Cilësisë dhe ZZHAC, gjithashtu janë publikuar në web faqen e Universitetit.

Takimet me KMCV-në

Janë mbajtur takimet e rregullta dy mujore me KMCV-në sic parashihen me Kalendarin Vjetor të Cilësisë. Datat e takimeve të mbajtura: 23.01.2024, 18.04.2024, 25.04.2024, 17.09.2024.

Takimet me Koordinatorët e Cilësisë

Janë mbajtur takimet e rregullta mujore me KC dhe ZZHAC të parapara në Kalendarin Vjetor të Cilësisë.

Vlerësimet semestrale për njësi akademike

Tabela më poshtë paraqet përqindjet mesatare të performancës në semestrin dimëror dhe veror për vitin akademik 2023/2024 programe të ndryshme studimi nëpër njësi të akademike.

Kolonat: Tabela përmban përqindjet e performancës për secilin program në dy periudha akademike: semestri dimëror dhe semestri veror.

Rreshtat: Lista e programeve përfshin: Fakulteti Edukimit bachelor, Fakulteti Edukimit master, Fakulteti Juridik bachelor, Fakulteti Juridik master, Fakulteti Ekonomik bachelor,

Fakulteti i Shkencave Aplikative bachelor, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike bachelor, dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike master.

Vlerat mesatare: Performanca për semestrin dimëror është mesatarisht 4.53%, ndërsa për semestrin veror është pak më e ulët, 4.48%.

Nga të dhënat, vërehet një stabilitet në përqindjet mesatare ndërmjet dy semestreve, me disa ndryshime të vogla për secilin program. Performanca më e lartë në semestrin veror është te programi Fakulteti Juridik master (4.93%), ndërsa vlerat më të ulëta në të dy semestrat janë tek programet Fakulteti i Shkencave Kompjuterike master (4.42%-4.49%).

Programi	Semestri Dimëror (%)	Semestri Veror (%)
Fakulteti Edukimit (BA)	4.59	4.67
Fakulteti Edukimit (MA)	4.7	4.77
Fakulteti Juridik (LLB)	4.36	4.5
Fakulteti Juridik (LLM)	4.63	4.93
Fakulteti Ekonomik	4.48	4.43
Fakulteti i Shkencave Aplikative(BSc)	4.63	4.43
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike (BSc)	4.45	4.44
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike (MSc)	4.49	4.42
Mesatarja e Përgjithshme	4.53	4.48

Tabela 2. Përqindjet mesatare të performancës për semestrin dimëror dhe veror

Trajnimet e mbajtura

Prorektorja për Zhvillim Akademik dhe Cilësi së bashku me Drejtoreshën e Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi kanë mbajtur trajnim në lidhje me Manualin e AKA-së që është organizuar nga Agjencia për Akreditim.

Vlerësimi i cilësisë së programeve akademike

Zyra ka realizuar një vlerësim të thelluar të cilësisë së programeve akademike, duke

përdorur standardet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës dhe udhëzimet ndërkombëtare. Ky proces ka përfshirë:

- Mbledhjen e të dhënave për performancën e programeve përmes pyetësorëve të studentëve dhe stafit.
- Analizimin e feedback-ut të studentëve mbi përmbajtjen e kurrikulave dhe metodologjinë e mësimdhënies.
- Hartimin e raporteve për komisionet përkatëse të akreditimit.

Përgatitjet për proceset e Akreditimit dhe Ri-akreditimit

Në bashkëpunim me njësitë akademike dhe administrative, zyra ka punuar intensivisht për përgatitjen e dosjeve për akreditim dhe ri-akreditim. Procesi ka përfshirë:

- Përgatitja e dokumenteve për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës si dhe regjistrimin i të dhënave personale të Stafit Akademik në platformën e re e-akreditimi, të gjatë muajit Korrik 2024.
- Procesi i ri-akreditimit të programeve akademike, mbajtja e mbledhjeve rreth informimit të procesit të ri akreditimit të programeve ekzistuese.
- Organizimin e takimeve me stafin për përgatitjen e vetëvlerësimeve dhe përmirësimin e dokumentacionit mbështetës.

Organizimi i Vizitave të Ekspertëve Ndërkombëtar për Akreditim në Universitetin Tonë

Në bashkëpunim me Agjencinë për Akreditim, janë organizuar vizitat e ekspertëve ndërkombëtarë në Universitetin tonë për riakreditimin institucional dhe të programeve akademike. Më poshtë janë paraqitur datat dhe qëllimet e vizitave:

1. Ri-akreditim Institucional

- **08.02.2024:**
-Vizita për Ri-akreditim Institucional.

2. Ri-akreditim dhe Akreditim të Programeve Akademike

- **24.04.2024:**
-Ri-akreditim i programit **Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale (MSc)**.
-Ri-akreditim i programit **E-Qeverisja (MSc)**.
- **30.04.2024:**

- Ri-akreditim i programit **Arsimi Parafillor (BA)**.
- Ri-akreditim i programit **Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (MA)**.
- Ri -akreditim i programit **Mësimdhënie në Kurrikula në Arsimin Fillor (MA)**.
- Akreditim i programit **Mësimdhënie në Gjuhë Angleze (MA)**.

- **21.05.2024:**

-Akreditim i programit **Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Europiane (BSc)**.

- **28.05.2024:**

-Akreditim i programit **Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar (BSc)**.

-Akreditim i programit **Marketing dhe Menaxhim i Shitjes (BSc)**.

Këto vizita kanë qenë pjesë e procesit të përkushtuar të universitetit për të siguruar cilësi të lartë në programet akademike dhe për të përmbushur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit

Rishikimi i Kalendarit Vjetor të Cilësisë

Rishikimi i Kalendarit Vjetor të Cilësisë ka ndodhur gjatë muajit Tetor nga Drejtoresha e Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësisë, ku më pas është diskutuar në KMCV.

Përgatitja e procesit pas Akreditimit dhe Ri-akreditimit

Pas pranimit të vendimeve nga KSHC-ja për ri/akreditimin institucional dhe programeve në UKZ, një nga kërkesat kryesore ka qenë adresimi dhe dorëzimi i Raportit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ekspertët e jashtëm ku data e fundit ka qenë 15.11.2024. Në këtë kuadër, janë mbajtur takime për hartimin dhe finalizimin e Raportit mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve, si në nivel institucional ashtu edhe për secilin program veçmas.

Përgatitja e Planit të Veprimit në nivel Institucional dhe të Njësive Akademike

Përgatitja e planit të veprimit në nivel Institucional, siç është parashikuar në Kalendarin Vjetor të Cilësisë, u realizua përmes takimeve të mbajtura më datat 19 dhe 20 qershor 2024. Në këto takime morën pjesë menaxhmenti i Universitetit, dekanët e njësive akademike, si dhe përfaqësues të stafit administrativ.

Ndërkohë, njësitë akademike kanë krijuar grupet e tyre të punës dhe kanë hartuar planet e tyre të veprimit në përputhje me prioritetet dhe kërkesat specifike të secilës njësi.

3. Statistika dhe rezultate kryesore

- Numri i programeve të akredituara dhe ri-akredituara.

Në vitin 2024, Universiteti "Kadri Zeka" ka arritur një sukses të rëndësishëm duke u riakredituar në nivel institucional për një periudhë pesëvjeçare. Gjatë këtij viti, janë akredituar edhe tre programe të reja në Fakultetin Ekonomik: **Financa dhe Kontabilitet i Aplikuar (BSc)**, **Marketing dhe Menaxhim i Shitjes (BSc)** dhe **Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Europiane (BA)**. Për të mbështetur këto zhvillime, është themeluar edhe **Fakulteti i Shkencave Sociale**.

Gjithashtu, pesë programe ekzistuese janë riakredituar, duke përfshirë:

- **Arsimi Parashkollor (BA)**,
- **Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (MA)**,
- **Mësimdhënie në Kurrikula në Arsimin Fillor (MA)** – të gjitha këto nga Fakulteti i Edukimit;
- **E-Qeverisja (MSc)** dhe
- **Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale (MSc)** – dy programe të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike.

Këto arritje reflektojnë përkushtimin e universitetit për të ofruar programe cilësore dhe për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të punës.

Gjatë vitit 2024, Universiteti "Kadri Zeka" ka aplikuar për riakreditimin e tre programeve ekzistuese: **Juridik i Përgjithshëm (LLB)**, **Juridiko-Penal (LLM)** dhe **Arsimi Fillor (BA)**. Po ashtu, janë dorëzuar aplikime për akreditimin e tre programeve të reja: **Analiza Ekonomike dhe Politika e Zhvillimit**, **Mësimdhënie në Gjuhën Angleze dhe Matematika dhe STEM**. Për të gjitha këto aplikime, universiteti është në pritje të përgjigjes nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).

Institucioni i Arsimit të Lartë	Programi i studimit	I akredituar deri
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Europiane, BA 180 ECTS	1 Shtator 2024– 30 Shtator 2027
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar, BSc 180 ECTS	1 Shtator 2024– 30 Shtator 2027
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Shkenca Kompjuterike, BSc 180 ECTS	1 Shtator 2022 – 30 Shtator 2027
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Marketing dhe Menaxhim i Shitjes, BSc 180 ECTS	1 Shtator 2024 – 30 Shtator 2027
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Juridik i Pergjithshëm, LLB 240 ECTS	30 Shtator 2025 – Në Proces
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Programin Fillor, MA 60 ECTS	1 Shtator – 30 Shtator 2027
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, MA 60 ECTS	1 Shtator – 30 Shtator 2027
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	E-Qeverisja, MSc 120 ECTS	1 Shtator – 30 Shtator 2027
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale, MSc 120 ECTS	1 Shtator – 30 Shtator 2027
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Juridiko – Penal, LLM 120 ECTS	30 Shtator 2024 – Në Proces
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Mësimdhënie në Gjuhë Angleze, MA 60 ECTS	Në Proces
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Analiza Ekonomike dhe Politika e Zhvillimit, MSc 120 ECTS	Në Proces
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Matematike dhe STEM, BSc 180 ECTS	Në Proces
Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan	Edukimi Fillor, 240 ECTS	Në Proces

Tabela 3. Programet e ri akredituara, akredituara dhe në proces në UKZ

4. Përfundime edhe Rekomandime

Nga analiza e raportit të Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi mund të nxirret përfundimi që zyra ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe administratës brenda institucionit. Aktivitetet e realizuara kanë përfshirë mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve, organizimin e aktiviteteve trajnuese, si dhe promovimin e kulturës së cilësisë.

Përfundime:

1. Zyra ka demonstruar angazhim të madh në zbatimin e standardeve të cilësisë dhe në përshtatjen e proceseve akademike dhe administrative me to.
2. Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve për zhvillimin profesional ka qenë një element kyç në mbështetjen e stafit akademik dhe administrativ.
3. Pavarësisht përpjekjeve, ka hapësirë për përmirësim në disa fusha, sidomos në trajnimin e vazhdueshëm dhe zbatimin efektiv të mekanizmave të vlerësimit.

Rekomandime:

1. **Organizimi i më shumë trajnimeve** – Sugjerohet që të mbahen më shumë aktivitete trajnuese si për stafin akademik, ashtu edhe për atë administrativ, duke adresuar nevojat specifike të tyre për zhvillim profesional.
2. **Zgjerimi i mbulimit të trajnimeve** – Të sigurohet që trajnimet të përfshijnë fusha të reja si përdorimi i teknologjisë, metodat e reja të mësimdhënies dhe praktikat më të mira në administrim.
3. **Përforcimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë** – Të zhvillohen dhe implementohen metoda më efektive për matjen e performancës së stafit dhe studentëve për të identifikuar dhe adresuar boshllëqet.
4. **Promovimi i kulturës së cilësisë** – Të nxitet një kulturë ku cilësia perceptohet si përgjegjësi kolektive dhe jo vetëm detyrë e një zyre specifike.
5. **Mbështetje më e madhe nga udhëheqësia** – Të sigurohet që udhëheqësia e institucionit të ofrojë mbështetje të plotë për aktivitetet e zhvillimit të cilësisë dhe t'i japë prioritet këtij sektori në planifikimin strategjik.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të ndihmonte në ngritjen e mëtejshme të standardeve të cilësisë dhe rritjen e efikasitetit të punës brenda institucionit.